

KONTRATË DHURIMI KUOTE

Sot, më datë 20 shkurt 2025 lidhet kjo Kontratë Dhurimi ("**Kontrata**") ndërmjet:

- 1) **Përparim Kalo**, shtetas shqiptar, lindur në Kuçovë më 12.12.1957 me letërnjoftim me nr. personal F71212078J, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, në cilësinë e "**Dhuruesit**" nga njëra anë dhe
- 2) **Aigest Milo**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 04.04.1986 me letërnjoftim me nr. Personal I60404066V, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar,
- 3) **Eni Kalo**, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë më 21.04.1984 me letërnjoftim me nr. Personal I45421032N, madhore, me zotësi të plotë për të vepruar, në cilësinë e "**Pranuesve të Dhurimit**", nga ana tjetër

Hyrje:

- A. Në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, Dhuruesi mban pjesë që përfaqësojnë 69% të kapitalit të shoqërisë **KALO & ASSOCIATES SHPK**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar sipas legjislacionit të Shqipërisë me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): K31910009D ("**Shoqëria**");
- B. Pranuesit e Dhurimit, zotërojnë pjesë të kapitalit si më poshtë:
 - a. Aigest Milo, zotëron 11.5% të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë;
 - b. Eni Kalo, zotëron 19.5% të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë
- C. Dhuruesi dëshiron t'i dhurojë Pranuesve të Dhurimit 9% të pjesëmarrjes së tij në kapitalin e Shoqërisë, respektivisht 4.5% ortakut Aigest Milo, dhe 4.5% ortakës Eni Kalo, dhe Pranuesit e Dhurimit e pranojnë këtë dhurim.
- D. Për sa më sipër, lidhet kjo Kontratë me kushtet e mëposhtme:

Neni 1 - Objekti

- 1.1 Me anë të kësaj Kontrate, Dhuruesi transferon me dhurim 4.5% të pjesëmarrjes së tij në kapitalin e Shoqërisë Z. Aigest Milo dhe 4,5% Znj. Eni Kalo ("**Kuotat e Dhuruara**"), të cilët e pranojnë këtë dhurim.
- 1.2 Transferimi kryhet në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 1.3 Pas transferimit, pjesëmarrja në Shoqëri do të jetë si më poshtë:



- **Z. Përparim Kalo**, mban 60% të kapitalit të Shoqërisë.
- **Z. Aigest Milo**, mban 16 % të kapitalit të Shoqërisë.
- **Znj. Eni Kalo**, mban 24% të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 2 - Efektet e transferimit

- 2.1 Transferimi i pjesëve të kapitalit bëhet pa kundërshtpërblim.
- 2.2 Kalimi i pronësisë kryhet njëkohësisht me nënshkrimin e kësaj Kontrate.
- 2.3 Pranuesit e Dhurimit do të përfitojnë të gjitha të drejtat dhe do të marrin përsipër detyrimet që rrjedhin nga Kuotat e Dhuruara, nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate. Pranuesit e Dhurimit do të përfitojnë të drejtat dhe detyrimet lidhur me rezultatet financiare të Shoqërisë, duke përfshirë këtu të drejtën për të përfituar dhe shpërndarë dividend që nga viti financiar 2025.

Neni 3 – Kufizime ne transferimin e Pjeses së Dhuruar

- 3.1 Pranuesit e Dhurimit mund t'i transferojnë Pjeset e Dhuruara (apo një pjesë të tyre) çdo personi të tretë pa kundërshtpërblim me miratimin paraprak të Dhuruesit deri në vitin 2030.
- 3.2 Në rast se transferimi bëhet me kundërshtpërblim, atëherë vlera e plotë e përfituar nga Pranuesit e Dhurimit i transferohet menjëherë Dhuruesit. Për këtë qëllim, Pranuesit e Dhurimit duhet të informojnë menjëherë Dhuruesin për shitjen e Kuotave së Dhuruara tek një person i tretë dhe t'i paraqesin dokumentin e nevojshëm që përcakton vlerën e përfituar nga shitja e Kuotave të Dhuruara, duke përfshirë këtu kontratën e shitblerjes së kuotës.

Neni 4 - Deklarime dhe Garanci

- 4.1 Dhuruesi garanton Pranuesit e Dhurimit se pjesët e kapitalit janë të transferueshme dhe të lira nga çdo barrë, peng apo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 4.2 Pranuesit e Dhurimit pas transferimit të pjesëve të kapitalit sipas kësaj Kontratë Dhurimi janë mbajtës të të gjitha të drejtave dhe detyrimeve përkatëse, si pjesëmarrja në fitimet e Shoqërisë.

Neni 5 - Interpretimi i Kontratës

Kjo Kontratë Dhurimi do të interpretohet duke analizuar përmbajtjen e saj në tërësi. Në çdo rast, në se ndonjë nen ose fjalë është e paqartë, ajo duhet të shikohet në tërësinë e kësaj kontrate dhe në kuadrin e qëllimeve të të dyja Palëve për të lidhur këtë Kontratë.

Neni 6 - Informacioni dhe Dokumentet

Informacioni dhe dokumentet në këtë Kontratë janë të vërteta, të përditësuara dhe të plota, deri në këtë datë.

Neni 7 - Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që lindin nga kjo Kontratë Dhurimi do të zgjidhen me mirëkuptim nga Palët, në rast të kundërt Palët do t'i drejtohen Gjykatës kompetente shqiptare.

Neni 8 - Të ndryshme

- 8.1 Kjo Kontratë Dhurimi është hartuar dhe do të interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 8.2 Kjo Kontratë Dhurimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë ligjore.


DHURUESI

Përparim Kalo



PRANUESIT E DHURIMIT

Aigest Milo



Eni Kalo

